



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1053/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Halil Desku kandidat për asamblenë komunale në Klinë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)-Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2012, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Halil Desku kandidat për asamblenë komunale në Klinë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

URDHËROHET KQZ që të rinumëroj fletëvotimet në Vendvotimet 0815c/02D dhe 0811c/03D, dhe ky numërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

A R S Y E T I M

PZAP-i me datën 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Halil Desku kandidat për asamblenë komunale në Klinë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në të cilën kërkon që të bëhet krahasimi i FPR të fotokopjuara të cilat i ka bashkangjitur në ankesën e tij me ato që gjenden në QNR-KQZ për shkak të mungesave të votave të tij në këto Qendra Votimi.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit gjeti se:

- **ankesa është e bazuar**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe nga hetimi i bërë në QNR ka vërejtur se në FRK-në 0811c/03D dhe 0815/02D janë bërë gabime teknike

nga origjinali në fletën e dytë (indigo) ndërsa QV tjera të cilat përmenden në ankesë nuk janë të rinumëruara në QNR-KQZ dhe janë të njëjtat rezultate të cilat i posedon pala ankuese. Andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotimeve. Andaj PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 1053/2013 më datën 06.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i

